Project: Date ...../...../..10....

# Protokoll Nr 7

Ky protokoll mbahet sot më datë 25.07.2025 ora 10⁰⁰, në sallën e mbledhjeve të KB, pranë shtëpisë së Kulturës Divjakë, në katin e dytë, për zhvillimin e mbledhjes së radhës së Këshillit të Bashkisë Divjakë, për muajin Korrik 2025.

Në mbledhje marin pjesë këshilltorët:

Fatjona Budani, Deniko Stosa,
Blerim Daviolli
Elona Stambollin Shpëtim Sheshi
Elmerina Sina
Xhorxhi Kruti, Liri Biti
Indrit Zgjona, Ajete Mebelli
Gëzim Agolli
Elda Sinani, Jurgen Shuli
Majlinda Xhoro
Bido Dërmyshi Sahit Ibrahimaj
Seit Kajo
Antuela Gjini, Lili Biti
Adelajda Çuli

Kuorumi u plotësua dhe kalohet tek:

## Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Projekt vendim për miratimin e mbarimit për para afatit të mandatit të këshilltores znj. Ana Noka e subjektit politik "Partia Socialiste e Shqipërisë".
3. Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit Bashkiak Divjakë - Propozimi i kandidatëve për Kryetar të Këshillit, përgatitja dhe procedurat e votimit, shpallja e rezultateve të votimit dhe zgjedhja e Kryetarit të KB.
4. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes që u zhvillua më datë 25.6.2025
5. Informacion mbi zbatimin e VKB për muajin Qershor.
6. Projekt vendim për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Qershor 2025.
7. Projekt vendim: Për shtimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetin e Bashkisë Divjakë për v. 2025 nga financimet e huaja, si dhe miratimin e

Project: Date ...... /...... / ...........

një rishpërndarje fondesh në buxhetin e v. 2025.
8. Projektvendim: Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare z. Vladimir Zhuka për rehabilitimin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë.
9. Projektvendim: Për miratimin e treguesve përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2026-2028 B. Divjakë.
10. Projektvendim: Për miratimin e aktmarrëveshjes për projektin ndërtim trotuari, kryqëzimi Cërme-Sektor dhe rehabilitimin me ndriçues.
11. Projektvendim: Për miratimin në parim të projektit "Linja e kanalizimit të ujërave të zeza dhe shtesa e impiantit, Bashkia Divjakë.
12. Projektvendim: Për një ndryshim në VKB nr 70 datë 24.12.2024 "Për miratimin e niveleve të pagave të Bashkisë Divjakë, Nj. Adm dhe institucion në varësi për vitin 2025.
13. Projektvendim: Për një ndryshim në VKB nr 73 datë 30.12.2024 për miratimin e një shtese fondi dhe shpërndarje në buxh. e v. 2024, për rikualifikimin e tregjeve tradicionale për Bashkinë Divjakë.
1. Pika e parë e rendit të ditës.
- Miratimi i rendit të ditës.
Nënkryetarja zj. Lini Biti propozon para këshilltarëve shtesë në rendin e ditës për projektvendimin e ardhur nga Bashkia me nr 50 datë 23.07.2025, Për miratimin e një shtese fondi të transfertës së kushtëzuar në buxhetin e vitit 2025.
Do t'ju informoje se Komisioni i Ekonomisë dhe financave në mbledhjen e datës 23.7.2025 e shqyrtoi këtë projektvendim dhe vendosi që ta kalojë për miratim.
Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka dhe ditaje të tjera s'ka.
Hidhet në votim pika e parë e rendit të ditës së bashkuar me shtesën e cila do të radhitet në pikën e 14 (katërmbëdhjetë) të rendit të ditës dhe votohet me 20 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.
2. Pika e dytë e rendit të ditës

Për miratimin e mbarimit përpara afatit të mandatit të këshilltares znj. Ana Nako e subjektit politik "Partia Socialiste e Shqipërisë".

Zv. kryetarja znj. Dini Biti i jep fjalën për relatim znj. Elona Stambolliu e cila lexon raportin e komisionit të verifikimit të mandateve dhe i propozon këshilltarëve të miratojnë mbarimin përpara afatit të mandatit të këshilltares znj. Ana Nako e subjektit politik PSSH, për arësye se merr një funksion të papajtueshëm me funksionin e këshilltarit.

Pyetje s'ka, diskutime s'ka.

Hidhet në votim pika e dytë e rendit të ditës dhe votohet me 20 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

3- Pika e tretë e rendit të ditës.

Zgjedhja e kryetarit të këshillit bashkiak.

- Propozimi i kandidatëve për kryetar këshilli.

Relatoi z. Shpëtim Sheshi dhe propozoi në emër të grupit të këshilltarëve të subjektit PS kandidaten për kryetare të Këshillit të Bashkisë Divjakë znj. Dini Biti, duke bërë dhe një rezyme të shkurtër për këtë këshilltare.

- Propozoi dhe z. Sahit Ibrahimi z. Xhorxhi Kruti si kandidat për kryetar të Këshillit.

Zv. Kryetarja znj. Dini Biti i drejtohet këshilltarit z. Xhorxhi Kruti: A e pranoni propozimin si kandidat për kryetar këshilli?.

Për përgjigjet z. Xhorxhi Kruti: Jo nuk e pranoj. Propozime të tjera për kandidat për kryetar të këshillit të bashkisë nuk ka.

znj. Dini Biti: i fton komisionin e votimit që të fillojnë procedurat për votim, ku fton këshilltarët z. Gjergji Apolli, Julian Vraja dhe Adelajda Culi. Meqënëse këshilltari z. Julian Vraja mungon, znj. Dini Biti i drejtohet z. Shpëtim Sheshi që të propozojë nga subjekti i PS një anëtar tjetër komisioni.

z. Shpëtim Sheshi propozoi këshilltarin z. Blerim Davidhi.

Project: Date ...... /...... / ..........

Hidhet në votim anëtari i komisionit të vo-
timit z. Blerim Dauidhi dhe votohet me
20 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë
abstenim.
Komisioni i votimit i përbërë prej 3 anëtarësh
z. Gojart Apolli, z. Blerim Dauidhi dhe znj.
Adelajda Culi plotësojnë fletët e votimit
me një kandidat znj. Lin Biti e cila u
propozua dhe u miratua si kandidate për
Kryetare të Këshillit.
U plotësuan fletët e votimit, Këshilltorët
votuan në mënyrë të fshehtë, dhe pas votimit
Kryetari i Komisionit të votimit z. Gojart
Apolli lexoi Procesverbalin e Komisionit
të votimit para Këshilltorëve.
Komisioni i votimit për votimin për Kryetar
të Këshillit Bashkiak Divjakë, në procesin e
votimit për Kryetar të Këshillit për paraqet këto
rezultate: Votimi u krye për kandidaten znj.
Lin Biti. Në votim morën pjesë 18 (tetë
mbëdhjetë këshilltore, fletë votimi të gjetura
në kuti janë 18 tetëmbëdhjetë, fletë votimi
të vlefshme janë 18 (tetëmbëdhjetë, fletë vo-
timi të pavlefshme janë 0 zero fletë.
Nga procesi i numërimit të votave për kandidat
për Kryetar të Këshillit të Bashkisë Divjakë, rezultoi
se znj. Lin Zoi Biti ka marrë 18 (tetëmbëdhjetë
vota. Fitues me më shumë vota është znj.
Lin Biti me 18 tetëmbëdhjetë vota e cila
shpallet Kryetare e Këshillit të Bashkisë Divjakë.

4. Pika e katërt e rendit të ditës

- Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes që u
zhvillua më datë 25.6.2025.
Kryetarja znj. Lin Biti i drejtohet këshilltorëve:
A keni pyetje apo diskutime rreth procesverbalit?
pyetje s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e katërt e rendit të ditës
dhe votohet me 20 vota pro, asnjë votë
abstenim dhe asnjë votë kundër.

5- Pika e pestë e rendit të ditës.
Informacion mbi zbatimin e vendimeve të KB për muajin Qershor 2025.
Asgjë s'ka, diskutime s'ka.
Kryetarja znj. Din Biti: Duke se të kalojmë në pikën e 6 gjashtë të rendit të ditës po ju lexoj Raportin e Komisionit të ekonomisë dhe financave mbi shqyrtimin e projekt vendimeve të paraqitura nga Bashkia për miratim në këtë mbledhje.
Komisioni i ekonomisë u mblodh më datë 23.7.2025 dhe pasi shqyrtoi projekt vendimet vendosi të kalojmë për miratim projekt vendimin për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar -6% për m. Qershor 2025, pr. vend. për shtimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetin e bashkisë për v. 2025 nga financimet e huaja si dhe miratimin e një rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2025. Projekt vendimin për miratimin e dhënies së ndihmës financiare të z. Vladimir Zhuka, projekt vendimin për miratim të tarifave përfundimtare PBA 2026-2028, pr. v. për miratimin e aktmarrëveshjes për projektin ndriçimi trotuari kryqëzimi Çermë sektor dhe rehabilitimi me ndriçues, projekt vendimin për një ndryshim në VKB nr 70 datë 24.12.2024, mbi nivelet e pagave të v.2025.
Kryetarja znj. Din Biti i jep fjalën për të lexuar raportin e Komisionit të Urbanistikës znj. Elona Stambolliu e cila referon: Komisioni i urbanistikës u mblodh më datë 24.7.2025 dhe pasi shqyrtoi projekt vendimet vendosi: Të kalojë për miratim projekt vendimin për miratimin në parim të projektit "Linja e kanalizimit të ujrave të zeza dhe shtesa e rezervuarit, Bashkia Divjakë dhe të kalojë për miratim projekt vendimin për një ≠ në VKB nr 73 datë 30.12.2024 "Për miratimin e një shtese fondi dhe shpenzimeje në buxhetin e v. 2024 për rivitalizimin e tregjeve tradicionale.
Kryetarja znj. Din Biti kalon në pikën e 6. të r. ditës.
6. Pika e gjashtë e rendit të ditës.
- Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri 6% për m. Qershor 2025.

Për këtë projekt vendimi relator Drejtori i sektorit të ndihmës ekonomike z. Dedio Kuço, ku i propozon këshilltarëve që të miratoj familjet në nevojë të dala nga përpiktët e plotësuara nga sistemi për 17 familje me një fond prej 82125 lekë, të cilat janë: Elisabeta Zisi 10692 lekë, Afërdita Lupi 5940 lekë, Esmeralda Gjata 7920 lekë, Vitrina Sula 5940 lekë, Ymer Albajrami 1525 lekë, Elvira Shuma 2178 lekë, Evanthi Mako 5940 lekë, Kristina Kolndreu 2178 lekë, Alketa Meta 8712 lekë, Asllan Proshenu 4752 lekë, Kimona Krosniqi 2178 lekë, Elbeta Lupo 3703 lekë, Zef Kolndreu 4752 lekë, Linje Dosi 5720 lekë, Donika Sino 3146 l. Zegin Zegini 3703 lek, Fatime Tere 3146 lekë.
Tjetër s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e gjashtë e rendit të ditës dhe votohet me 20 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

7. Pika e shtatë e rendit të ditës
- Për miratimin e shtimit të të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetin e Bashkisë Divjakë për vitin 2025 nga financimet e huaja, miratimin e një rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2025.
Relator Drejtori i Financës dhe Buxhetit z. Xhelo-din Brahkolla duke i propozuar këshilltarëve që të miratojnë përfshirjen në Buxhetin e Bashkisë të fondeve nga projekti Jolinoble i cili bashkëfinan-cohet nga BE nëpërmjet programit Interreg IPA Adrion, ku vlera e plotë e projektit është 110950 Euro ose 10.859.786 lekë, nga e cila vlera prej 94308 Euro ose 9230818 lekë do të financohet nga partneri Interreg IPA, që do të jetë një shtesë në buxhetin e bashkisë, duke u planifikuar si e ardhur dhe si shpenzim.
Vlera prej 16643 Euro ose 1.628968 lekë do të financohet nga Bashkia Divjakë, dhe këto të shpërndara sipas viteve 2025, 2026, 2027 sipas përqyrës cila është e bashkëngjitur projekt vendimit.
Tjetër s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e shtatë e rendit të ditës

REPUBLIKA E SHQIP

dhe votohet me 20 votë pro, asnjë votë kundër dhe
asnjë votë abstenim.

8. Pika e tetë e rendit të ditës.
Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare
z. Vladimir Zhuka për rehabilitimin e dëmeve të
shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë, Divjakë.
Relatori z. Ardi Bullari dhe i propozoi këshilltarëve
që të miratojnë ndihmën financiare për zotin
Vladimir Zhuka me vlerën prej 59000 lekë për
çatin e djegur të shtëpisë prej 50 m².
Pyetje nga këshilltarët s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e tetë e rendit të ditës
dhe votohet me 20 votë pro, asnjë votë kundër
dhe asnjë votë abstenim.

9. Pika e nëntë e rendit të ditës.
- Për miratimin e tavaneve përfundimtare të
shpenzimeve për PBA 2026-2028 për Bashkinë Divjakë.
Relatori Drejtori i Financës dhe Buxhetit dhe i
propozoi këshilltarëve të miratojnë tavanet përfundim-
-tare të shpenzimeve për PBA 2026-2028 për B. Divjakë.

| Në lekë: Parashikimi | 2026 | 2027 | 2028 |
|---|---|---|---|
| a. Tavanet përfundimtare për T.K. | 789320726 | 793.506.597. | 805.006.960 |
| b. Tav. përf. + financim hua: | 793.172.304 | 797,044,959 | 805.006.960 |

Në mënyrë analitike i kemi bashkëngjitur pasqyrat projektit.
Pyetje s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e nëntë e rendit të ditës
dhe votohet me 20 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë
votë abstenim.

10. Pika e dhjetë e rendit të ditës.
- Për miratimin e Aktmarrëveshjes për projektin
ndërtim trotuari, kryqëzimi Cerme Sektor dhe
rehabilitimi me ndriçues.
Relatori Drejtori i Planifikimit dhe Zhvillimit të
Territorit z. Ardit Jauko duke sqaruar këshill-
-tarët për një fond të ardhur nga FZhSh. për
ndërtim trotuari tek kryqëzimi Cerme Sektor,
dhe rehabilitimi me ndriçues. Bashkia Divjakë
informohet nga ARRSH se në rrethrrotullimin e
fshatit Cerme e Sipërme dhe përgjatë aksit

Project: Date ...... /...... / ...........

kryesor, do të kryhen punimet për ndërtimin e autostradës Lekaj - Rrë, ky është në fazën e projektimit dhe nuk është miratuar ende. Nisur nga kjo situatë kërkojmë transferimin e projektit të filluar nga FSHZH nga Njësia Adm. Qukës, për tu zhvilluar në fshatin Kryekuq në Nj. Adm. Remas.

Nisur nga gjendja aktuale që ndodhen rrugët e brendshme në këtë fshat propozojmë që të gjitha materialet e përfituara nga lidhja e akt marrëveshjes me FSHZH të përdoren për sistemimin e rrugëve të brendshme të fshatit Kryekuq.

Për këtë akt marrëveshje jep sqarime dhe Kryetari i Bashkisë z. Josif Gorrea.

Kryetarja znj. Diana Bizi i drejtohet këshilltarëve: A keni pyetje për pikën e 10 të rendit të ditës?

z. Sahit [illegible]: A keni projekte për shtrimin e rrugëve dhe trotuareve të fshatit Kryekuq.

znj. Afete Mebelli: A ka afat për fillimin e punimeve për shtrimin e rrugëve?

Përgjigjet z. Josif Gorrea Kryetari i Bashkisë.

Pyetje znj. Elda Sinani: Përse ky fond të kalojë nga Cerme sektori në Kryekuq? Po për rrugët e Cerma sektorit dhe trotuaret keni ulur të planifikohen fondet? Ne e kemi kërkuar këtë shtrim trotuaresh sepse kalimi në rrugë i nxënësve për në shkollë është rrezik aksidentesh i përditshëm nga mjetet.

Përgjigjet z. Josif Gorrea, Kryetari i Bashkisë duke dhënë sqarime edhe njëherë për këtë investim dhe shprehet se do të rishikohet nga qeveria.

Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka.

Hidhet në votim pika e dhjetë e rendit të ditës dhe votohet me 20 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

11. Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës
- Për miratimin në parim të projektit ....
"Linja e kanalizimit të ujrave të zeza dhe shtesa e impiantit, Bashkia Divjakë.
Kryetarja znj. Lini Bizi i jep fjalën për relatim Drejtorit të Planifikimit dhe zhvillimit të territorit z. Ardit Jonka.
Ky i fundit sqaron këshilltarët: Ky projekt synon trajtimin e ujrave të ndotura përmes njësisë me reaktor biologjik, procesi është automatik pa ndërhyrjen e ndonjë përdoruesi me anë të kon-trollit siemens PLC. Procesi i zgjedhur për traj-timin zhvillohet në 4 faza: Faza e mbushjes, faza e reaksionit, faza e sedimentimit dhe faza e shkarkimit ku në fund të fazës së sedimen-timit, uji i trajtuar shkarkohet me pompën e shkarkimit, kjo fazë është quajtur si faza e shkarkimit ku në fund të kësaj faze cikli është i kompletuar.
Prandaj ju propozojmë që të miratoni në parim këtë projekt që emërtuar "Linja e kanalizimit të ujrave të zeza dhe shtesa e Impiantit për qytetin Divjakë. Mund të studioni dhe projektin që keni bashkëngjitur këtij relacioni.
Për këtë projekt jep sqarime dhe Kryetari i Bashkisë z. Josif Gorrea.
Tjetër s'ka diskutime s'ka. Largohet z. B. Daudhi.
Hidhet në votim pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës dhe votohet me 19 vote pro asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

12. Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës.
- Për një ndryshim në VKB nr 70 dt. 24.12.2024 për miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë, Nj. Adm dhe institucioneve në vartësi.
Relaton znj. Atalanta Simaku për këtë projekt vendim e cila është Përgjegjëse pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.
Ajo i propozon këshilltarëve që të miratojnë ndryshimin e klasifikimit të nivelit të drejtimit

për pozicionin Inspektor pyjor, pranë sektorit
të pyjeve dhe kullotave, Drejtoria e Bujq.
Mjedisit veterinarisë dhe Pyjeve nga arsimi i
lartë në arsimin të mesëm. Si rezultat i
ndryshimit të nivelit të arsimit pozicioni
i mësipërm i klasifikuar me parë në
klasin e IV-2 do të riklasifikohet duke u
trajtuar sipas pikës 11 të VKM nr 328 dt.
31.5.2023 i ndryshuar me VKM nr 503
datë 01.08.2024.
Paga e pozicionit nuk ndryshon dhe
mbetet 47.000 lekë pasi është në për-
-puthje me kufijtë e pagës për kategorinë
e riklasifikuar. Efektet e këtij ndryshimi
të fillojnë të zbatohen që nga dt.01.08.2025.
Sekretarja znj. Dini Bizi i drejtohet këshill
-tarve: A keni pyetje? Pyetje s'ka
A keni diskutime? Diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e dymbëdhjetë
e rendit të ditës dhe votohet me 19 vota
pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë
abstenim.

13. Pika e trembëdhjetë e rendit të ditës.
- Për një ndryshim në VKB nr 73 datë
30.12.2024 "Për miratimin e një shtese
fondi dhe shpërndarje në buxhetin e vitit
2024 për rivitalizimin e tregjeve tradicio
-nal për Bashkinë Divjakë.
Për këtë pikë relaton z. Ardit Jorko
Drejtori i Planifikimit dhe Zhvillimit
të Territorit duke sqaruar se Ministria
e Financave dhe Ekonomisë gjatë muajit
Dhjetor 2024 akordoi fondin në formën
e transfertës si pakushtëzuar sektoriale për
rivitalizimin e tregjeve tradicional me
vlerën 29.993.000 lekë, Ky fond do të
përdoret për rivitalizimin e tregut në kilo
metrin zero tek rrethrrotullimi i Gërmës.
Nga Autoriteti rrugor Shqiptar Bashkia

Divjakë informohet se në rrethrrotullimin
e fshatit Cerme e Sipërme dhe përgjatë
aksit kryesor do të kryhen punimet
për ndërtimin e autostradës Levan-Fier
Ky projekt është në fazën e projektimit
dhe projekti përfundimtar nuk është mi-
-ratuar ende por është bërë me dije
se në autostradën e projektuar nuk do të
ketë mundësi për ndërtimin e tregut
të projektuar nga ana e Bashkisë Divjakë
sepse do të humbas funksionalitetin e tij.
Nisur nga kjo situatë Bashkia Divjakë
kërkon transferimin e projektit nga Rreth
rrotullimi Cerme e Sipërme, Njësia
Adm. Tërbuf për tu zhvilluar në qytetin
Divjakë në zonën e Rezit në kanalin
e Vaut, dogana e Isaravastas, Nisur
nga fakti që qëllimi është po i njëjtë pro-
-pozojmë që të miratohet ndryshimi i
vendndodhjes së projektit nga Tregu kilometri
0 nga fshati Cermë e Sipërme Njësia Ad
ministrative Tërbuf në qytetin Divjakë
në zonën e Rezit në kanalin e Vaut, dogana
e Isaravastasë, Bashkia Divjakë si dhe
destinacionin në treg peshku.
Kryetarja znj. Lin Bibi: A keni pyetje?
Pyetje: z. Sahit Ibrahimaj: Çfarë funksioni
do të ketë tregu i peshkut? Kush do ta
ndërtojë? privati apo Bashkia?
z. Gjergjit Apolli: A na lejohet të ndërtojmë
në zonat e mbrojtura?
z. Jurgen Shuli: A do ti lejohet Bashkisë
që ta ndërtoj këtë treg në zonën e
mbrojtur? A është këshilluar me Minis-
-trit përkatëse për këtë investim?
Cili mendimi i komitetit i është marrë?
Për të gjitha pyetjet e këshilltarëve përgji-
-gjet Kryetari i Bashkisë z. Josif Gorrea
duke sqaruar për negociatat me qeverinë

Project: Date ..... / ..... / ..........

për ndërtimin e këtij projekti dhe për përdorimin e këtij fondi të akorduar nga Ministria e Financave për këtë qëllim.
Qyteti të tjera s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e trembëdhjetë e rendit të ditës dhe votohet me 19 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.
14 - Pika e katërmbëdhjetë shtesë e rendit të ditës.
Për miratimin e një shtese fondi të transferimit si kushtëzuar në buxhetin e vitit 2025.
Relator Drejtori i Financës dhe Buxhetit z. Xhelaldin Brahkola i cili i propozoi këshilltarëve të miratojnë një shtesë fondi të transferimit si kushtëzuar në buxhetin e vitit 2025 të ardhur nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me objektin "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara në vlerën 5.118.162 lekë dhe kjo e ndarë për vitet 2025 dhe 2026 përkatësisht nga 2.559.081 lekë për çdo vit.
Ky fond do të përdoret për përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara.
Vlera totale e projektit është 6.397.703 lekë nga e cila 80% do të mbulohet nga Ministria e Ekonomisë në vlerën 5.118.162 lekë dhe 20% do të mbulohet nga Bashkia në vlerën 1.279.541 lekë të cilat u miratuan me VKB nr 12 dt. 24.02.2025.
z. Xhelaldin Brahkola theksoi se kushti i rëndësishëm është që fondi për vitin 2025 të përdoret brenda vitit 2025.
Për këtë sqaroi dhe Kryetari i Bashkisë,

Pyetje z. Jurgen Shuli: Në Terbuf[?] kemi një familje me nd. ek dhe invalid si ... dhe shtëpia ka nevojë për riparim.

z. Afete Meleli: Edhe në fshatin Kryekup ka familje me nd. ek që kanë nevojë për riparim shtëpie.

Sqaroi për këtë projekt vendim Kryetari i Bashkisë.

Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka.

Hidhet në votim pika e katërmbëdhjetë pika shtesë e rendit të ditës dhe votohet me 19 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

Kryetarja znj. Lini Bitri: Kalojmë në pikën të tjetër.

Pyetje: znj. Donika Stasa: Kur do të mbarojë së ndërtuari shkolla Remas. A do të fillojmë mësimin nxënësit në shtator?

Përgjigjet Kryetari i Bashkisë: Po do të fillojnë mësimin. Janë duke përfunduar punimet.

znj. Elda Sinani: Në Cermë sektor uji i pijshëm është me shumë klor dhe ka shumë ndërprerje jemi në një temperaturat janë shumë të larta. Është shumë problematike kjo situatë.

Kryetari i Bashkisë: Po, keni të drejtë, do interesohem.

z. Jurgen Shuli: Kërkojmë ujë për vaditje, nuk ka, fshatarët e kanë shumë problem për vaditjen e tokave.

z. Xhorxhi Kruti: Edhe ne në Divjakë kemi mungesë uji për vaditje, si bëhet?

z. Sokit Skoduminaj: Diskutojmë se uji për vaditje nuk menaxhohet por po shpërdorohet shumë.

z. Jurgen Shuli: Janë bërë prita nëpër kanale dhe nuk ka ujë për vaditje.

Project: Date ...... /...... / ..........

2. Gjergji Shuli: Tek vende e madhe në kishovane po bëhen punime, çfar po ndërtohet?
Përgjigjet Kryetari i Bashkisë: Po ndërtohet një pritë për grumbullimin e ujit për t'u përdorur për vaditje.
2. Gjoni Apolli: Edhe në një grobjon kemi probleme për vaditjen e tokave.
Kryetarja pasi nuk ka pyetje e diskutime të tjera e deklaron mbledhjen të mbyllur.

Sekretari i KB,
Mimoza Gjoni

Kryetari i KB,
Liri Bitri

Gjoni Apolli

Elona Stambolli

Elmerina Ging

Majlinda Xhani

Adelajda Çulli

SEIT KIARO

Eldis Sirani

Bido Dermyshi

Antuela Grio

Fatjona Bulai

Donika Stasa

Indrit Zgjona

Ajete Metalli

S. Ilhamaliu